



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS
GOVERNMENT OF KOSOVO
VLADA KOSOVA

Qeveria e Kosovës,

Duke u bazuar në nenet 1.3 pika (c), 1.6 dhe 1.7 të Rregullorës së UNMIKUT nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë;

Duke parasysh pikën 1 dhe 3 të vendimit nr.13/277 të Qeverisë së Kosovës, të nxjerrë më 31.10.2007 ;

Më qëllim të sigurimit të pensioneve me të favorshme për pensionistët kontributpagues dhe me stazh të sigurimit pensional ;

Nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 11/2007
PER
ZBATIMIN E VENDIMIT NR.13/277 TË QEVERISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i nxjerrjes së këtij Udhëzimi Administrativ është rregullimi i njohjes së të drejtës në rritje të pensionit bazë si dhe përcaktimi i rregullave praktike , kushteve , kriterëve, dhe procedurave për zbatimin e vendimit të Qeverisë nr.13/277 të nxjerrë më 31.10.2007 përmes të cilit është vendosur që pensionet bazë, për pensionistët me stazh sigurimi, pensional të rriten nga 40 euro në 75 euro, duke filluar më 01.01.2008.

Neni 2
E drejta në rritje të pensionit bazë

(1) Të drejtën për të përfituar në rritje të pensionit bazë prej 40 euro në 75 euro e kanë :

1. Të gjithë shfrytëzuesit aktual të pensioneve bazë të cilët kanë qenë të siguruar dhe kontributpagues, në bazë të marrëdhënies së punës dhe
2. Të gjithë personat të cilët në të ardhmen aplikojnë për pensionet bazë, të cilët ofrojnë dëshmi se kanë qenë të siguruar dhe kontributpagues në bazë të marrëdhënies së punës.

(2) Përfituesit sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni të drejtën në rritje të pensionit prej 40 euro në 75 euro do ta realizojnë nga 01.01.2008

Neni 3
Kushtet dhe kriteret përgjithshme për përfitim në rritje të pensionit bazë.

Shfrytëzuesit aktual të pensionit bazë dhe personat të cilët në të ardhmen do të aplikojnë për këto pensione , për të përfituar në këtë rritje , sipas vendimit të Qeverisë nr13/277, duhet përmbushur këto kushte dhe kriteret të përgjithshme:

1. Parashtruesi i kërkesë duhet të ketë moshën 65 vjet dhe minimum 15 vjet stazh të sigurimit pensional
2. Duhet të jetë banor-rezident i përhershëm i Kosovës
3. Duhet të ketë letërnjoftimin e UNMIK-ut si dhe
4. Nuk duhet të jetë shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale-sociale të aplikueshme në Kosovë apo i ndonjë pensioni të fituar jashtë vendit në bazë të punës së kaluar ose të invaliditetit , duke përjashtuar skemën pensionale për vlerat e luftës së UCK-së.

Neni 4
Kushtet dhe kriteret e veçanta për përfitim në rritje të pensionit bazë

(1) Për realizmin e rritjes së pensionit bazë nga 40 euro në 75 euro , përfituesi i rritjes së pensionit duhet të plotësoj edhe këto kushte dhe kriteret të veçanta :

1. Të ketë dëshmi se në të kaluarën ka qenë i siguruar në bazë të marrëdhënies së punës dhe shfrytëzues i pensionit të pleqërisë kontributpagues , me bazë të stazhit të sigurimit pensional sipas dispozitave ligjore të sigurimit pensional dhe invalidor të Kosovës . (Kriteri zbatohet për shfrytëzuesit aktual të pensionit bazë)

2. Që në momentin e arritjes së moshës 65 vjeçare, parashtruesi i kërkesës me rastin e aplikimit për pensionin bazë të ofroj dëshmi se ka qenë i siguruar në bazë të marrëdhënie së punës dhe se posedon stazhin e sigurimit pensional, minimum prej 15 vitesh (Kriteri zbatohet për aplikuesit e rij të cilët do të aplikojnë në të ardhmen për pensionet bazë) .

Neni 5

Procedurat administrative për realizimin e rritjes së pensionit bazë

- (1) Çdo shfrytëzues aktual i pensionit bazë dhe qdo person i cili e arrin moshën e pensionimit prej 65 vitesh , të cilët i përmbushin kushtet dhe kriteret, sipas dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ , mund të aplikojnë për të përfituar në rritje të pensionit bazë , sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në nenin 2 të këtij akti nënligjor .
- (2) Parashtruesi kërkesës i cili plotëson kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të vendimit të Qeverisë nr.13/277 dhe këtij Udhëzimi Administrativ ,mund të aplikoj për përfituar në rritje të pensionit bazë, në Zyrën më të afërt regjionale të Departamenti të Administratës Pensionale (DAPK) të MPMS-së, duke plotësuar formularin për aplikim i përgatitur nga DAPK-ja.
- (3) Parashtruesi i kërkesës , krahas kërkesë me shkrim – plotësimit të formularit , duhet të paraqes edhe dokumentet e nevojshme për të konfirmuar se i plotëson kushtet dhe kriteret për realizimin e rritjes së pensionit bazë .
- (4) DAPK-ja, pas pranimit të kërkesës dhe dokumentacionit valid , në afat prej 60 ditësh , vendos me akt administrativ , lidhur me kërkesën e paraqitur për përfitim në rritje të pensionit bazë.
- (5) Parashtruesi i kërkesës të drejtën në rritje të pensionit bazë do ta realizoj , nga dita e parashtrimit të kërkesës .
- (6) Afati për aplikim lidhur me realizimin e të drejtës në rritjen e pensionit bazë, është nga dita e hyrjes së fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ e më tutje .

Neni 6

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- (1) Krahas kërkesës, me rastin e dorëzimit të aplikacionit , parashtruesi kërkesës sipas pikës 1 të nenit 4 duhet të dorëzoj edhe këto dëshmi:
 1. Çekun për pagesën e pensionit kontributpagues dhe
 2. Vendimin se ka qenë shfrytëzues i pensionit sipas dispozitave ligjore të mëhershme të sigurimit pensional dhe invalidor të Kosovës,

(2) Me rastin e dorëzimit të aplikacionit , parashtuesi i kërkesës sipas pikës 2 të nenit 4 duhet të dorëzoj këto dëshmi :

1. Librezën e punës me numrin amëz të të siguruarit ose
2. Të ofroj dëshmi se i ka paguar kontributet vet dhe punëdhënësi ku ka punuar, të cilat dëshmi detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e DAPK – së , sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989.

Neni 7

Pranimi dhe verifikimi dokumentacionit

- (1) Zyrtari përgjegjës i DAPK-së do ti pranoj të gjitha aplikacionet e kompletuara me dokumente përkatëse për rritje të pensionit, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Procedurës Administrative .
- (2) Pas pranimit dhe verifikimit të aplikacionit dhe dokumentacionit tjetër valid, zyrtari përgjegjës i DAPK-së, aplikuesit duhet ti lëshoj një vërtetim mbi dorëzimin e aplikacionit .
- (3) Aplikacioni i pranuar sipas pikës 2 të nenit 4 me të gjitha dëshmitë për pensionin bazë-kontributpagues, verifikohet nga zyrtari përgjegjës i evidencës amë të sigurimit pensional dhe invalidor.
- (4) Pas verifikimit dhe konstatimit nga zyrtari i evidencës amë , se aplikuesi i plotëson kushtet dhe kriteret për rritje të pensionit të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ, dokumentacioni procedohet ne procedurat e mëtejme vendim marrëse, në kuadër të DAPK-së të MPMS-së.

Neni 8

Dokumentet shtesë të Udhëzimit Administrativ

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ, është vendimi i Qeverisë nr.13/277, Formulari për aplikim i përgatitur nga DAPK-ja si dhe çdo dokument tjetër i nevojshëm i cili do të shërbej për realizmin e drejtë dhe efikas të rritjes së pensioneve bazë sipas dispozitave të këtij akti nënligjor.

Neni 9

Zbatimi i Udhëzimit Administrativ

Për zbatimin e drejtë dhe efikas të këtij Udhëzimi Administrativ do të përkujdesen Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave , përkatësisht , departamentet përgjegjëse të këtyre dy ministrive .

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ, hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa do të aplikohet nga 01 janari 2008.

Prishtinë, nëntor 2007

Ministri i MPMS

Ibrahim Selmanaj